

Reagimi i Sead Morinës ndaj lajmit “QKUK-ja një vit pa material për proteza”

E nderuar redaksi pas publikimit të lajmit nga portali juaj, dhe shumë portaleve tjera, ishte arsyeshëm reagimi i kompanisë tonë nga lajmi i pa argumentuar.

E nderuar redaksi Agjencioni Antikorrupcion edhe pse e ka mbajtur lenden një muaj në shqyrtim nuk ka dhënë opinion se është konflikt interesi, (Ju lutem shikon opinionin e Agjencisë në Attachment)

E nderuar redaksi OSHP ja ka anuluar tenderin për shkak se njësi kërkuese ose përpiluesi i tenderit ka përpiluar tenderin në mënyrë shumë jo profesionale (Ju lutem shikoni vendimin e OSHP)

Vendim i OSHP-së ka qenë që nuk ka konflikt interesi (Ju lutem shikoni vendimin e OSHP-së)

Ne në këtë tender kemi marrë pjesë për herë të parë, me produktet e kompanisë Gjermane OTTO BOCK. Këto produkte janë më çmime shumë më të larta në treg, ndërsa kemi arritur që të jemi më të lirë prej 7000 euro nga kompania tjetër që kishte fituar tenderin më shumë se 10 vite. Pra ne jo vetëm që kemi ofruar produkte shumë kualitative për proteza e orteza, dhe me çmim më të lirë, por edhe kemi shkatërruar monopolin e krijuar në këtë tender.

Nëse do të ishte konflikt interesi atëherë kompania tjetër automatikisht do të kishte fituar tenderin,

Ju si gazetar hulumtues ju lutem shtroni disa pyetje në lidhje me këtë procedurë prokurimi

1. Otto Bock çfarë renome ndërkombëtare posedon ?
2. Pse një kompani që ka fituar tenderin më shumë se 10 vite nuk mundi të fitojë në vitin 2016?
3. Pse kompanitë e reja nuk po mundin të fitojnë tender, pra siç jemi ne?
4. Kompania tjetër me të njëjtin përshkrim e ka fituar tenderin më shumë se 10 vite, e pse ortoprotech nuk e fitoi?
5. Si dhe shumë pyetja tjera mund të i shtroni nëse jeni profesional

Me respekt

Sead Morina Ortoprotezist

---

Përgjigja e Redaksisë

I nderuar Sead Morina ju faleminderit për reagimin tuaj. Dëshirojmë t'ju njoftojmë se menjëherë kemi marrë masa për të adresuar çështjet e ngritura nga ju.

Me të marrë informacionin nga ana juaj se tenderi nuk është anuluar për shkak të konfliktit të interesit ne kemi reaguar menjëherë dhe e kemi përmirësuar.

Në fund të tekstit ndodhet edhe fusnota se teksti është përmirësuar dhe edituar për atë pjesë.

Përsa ju përket pretendimeve të tjera pse OSHP dhe autoritetit kontraktues e ka anuluar tenderin dhe nëse vendimi ka qenë i drejtë kjo mund të jetë subject i një storie të ardhshme të cilën ne jemi të gatshëm ta hulumtojmë.

Ju lusim të na ofroni numrin e kontaktit për t'ju telefonuar dhe diskutuar rreth pretendimeve tuaja rreth anulimit të tenderit.

shkrimi i edituar <http://kallxo.com/gkuk-ja-ge-nje-vit-pa-material-per-proteza/>

Me respekt

Kreshnik Gashi Redaktor Menaxhues KALLXO.com